



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 513/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada – Glllogjani kryesuese, Milena Đerić dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi-Pireva, duke vendosur përkitazi me ankesën e Anesa Karadzi nga radhët e subjektit politik Bashkimi Social Demokratik, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 14.02.2021 në seancën e panelit të mbajtur me 16.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e palejuara ankesa A.nr.513/2021 të datës 15.02.2021, të parashtruar nga Anesa Karadzi nga radhët e subjektit politik Bashkimi Social Demokratik, për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 14.02.2021.

A r s y e t i m

Paneli, me datë 15.02.2021, ka pranuar ankesat A.nr.513/2021, nga Anesa Karadzi nga radhët e subjektit politik Bashkimi Social Demokratik, në të cilat pretendohet se në ditën e votimit në Qendrën e Votimit 1706c në Vitomicë, ka pasur parregullsi gjatë votimit, ku thekson se nuk ka pasur komisioner e as vëzhgues gjatë procesit të votimit. Më tej në ankesë pretendohet se në këtë Qendër të Votimit nuk përputhet numri i votave me numrin e supozuar të votave.

Parashtruesja e ankesës kërkon nga PZAP-i që të formohet një komision i pavarur për të bërë rinumërimin e këtyre votave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar.

Paneli vlerëson se pretendimi i palëve ankuese edhe pse i referohen parregullsive në ditën e votimit, për shkak se përmes këtyre ankesave atakohet rezultati i cili është ende si rezultat preliminar, e i cili rezultat mund të ndryshoj, ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankimueshëm nga subjektet politike edhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me

numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor-faza e procesit zgjedhor kur parashtrohet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hudhet poshtë si e palejueshme.

Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe të pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi për hudhjen e ankesës të palejueshme nuk e prejjudikon rezultatit përfundimtar e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore palët mund ta atakojnë/apelojnë rezultatit përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 513/2021 më datën 16.02.2021

Kryesuese e Panelit
Afijete Sada – Gllogjani



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*